MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me objekt "Mbi realizimin e të ardhurave tatimore në vitin ushtrimor 2011, planifikimi i buxhetit dhe realizimi faktik i tij" për vitin 2011 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.134, datë 21/09/2012.
Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 423/13, datë 21/09/2012 dërguar Z. Gazmir Spahia, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. Masa organizative

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të analizojë me të gjithë stafin, Raportin Përfundimtar të Auditimit në të cilin janë paraqitur shkeljet e konstatuara, ndërkohë të përgatisë një program pune të veçantë me persona përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të dërguara bashkëlidhur këtij raporti.

Menjëherë

2. Të analizohen treguesit ekonomik të realizimit të ardhurave për TVSH-në, tatim mbi fitimin, borxhin tatimor dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të merren masa për përmisimin e tyre në periudhën në vijim

Vazhdimisht

3. Të meren masa për hartimin dhe miratimin e Manualit të Procedurave për Shërbimet ndaj Tatimpaguesve, në zbatim të pikës 12.3 të Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore

Brenda vitit ushtrimor 2012

4. Të ngrihet në një nivel të ri bashkëpunimi ndërmjet strukturave të DPT-së, me qëllim që borxhi i trashëguar apo borxhi i ri, të administrohet në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit fiskal, si dhe të bëhet një rakordim i saktë i borxhit tatimor të administruar e kontabilizuar nga Drejtoritë e Përpunimit dhe Menaxhimit të Ardhurave, me të dhënat e borxhit që administrojnë Drejtoritë e Mbledhjes së të Ardhurave

Vazhdimisht

5. Të merren të gjitha hapat ligjore për pakësimin e gjendjes së borxhit në vlerën prej 64,510 milionë lekë dhe zbatimin në kohë të proçedurave ligjore të vjeljes së tij, me qëllim që subjekteve debitorë të mos ju parashkruhet borxhi dhe të shërbejë si një faktor në realizimin e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit

Vazhdimisht

6. Të ushtrohen kontrolle e vizita në Drejtoritë Rajonale Tatimore për të shqyrtuar funksionimin e mbledhjes së detyrimeve dhe masave shtrënguese nga zyra, dhe vënien para përgjegjësisë të personale përgjegjës që nuk kryejnë detyrat e ngarkuara

Vazhdimisht

7. Në auditimet e kryera të përcaktohen saktë gjetjet e konstatuara dhe të analizohen ato, si dhe të përcaktohen përgjegjësitë përkatëse

Vazhdimisht

8. Masat disiplinore të propozuara nga Drejtoria Auditit Brendshëm të jenë të argumentuara saktë me shkeljet e konstatuara sipas personave përgjegjës, dhe në përputhshmëri me ligjin, gjithashtu të insistohet për marjen parasysh të tyre

Vazhdimisht

9. Të përgatitet dhe të bëhet analizë e raporteve mujor të punës, duke trajtuar problemet e ngritura, masat e përcaktuara dhe ndikimi i tyre në njësitë vartëse të saj pranë Drejtorive Rajonale Tatimore

Brenda vitit ushtrimor

10. Të studiohet mundësia e planifikimit të kontrolleve tatimor, për të përfshirë më shumë se sa është konstatuar, subjekte me humbje. Në tërësi, numri i kontrolleve të shpërndahet midis Drejtorive Rajonale Tatimore, duke u orientuar edhe nga madhësia e numrit të subjekteve si dhe qarkullimi i deklaruar.

Vazhdimisht

11. Të bëhet analizë e dokumentuar për performancën e inspektorëve të kontrollit tatimor për çdo drejtori rajonale,të jepen përfundime dhe të përcaktohen përgjegjësi individuale për çdo inspektor

Vazhdimisht

12. Të bëhen analiza për ngushtimin e bazës së tatueshme për çdo drejtori rajonale tatimore, të përcaktohen shkaqet objektive dhe jo objektive, si dhe të përcaktohen masa konkrete që ky tregues të përmirësohet mbi baza ligjore

Vazhdimisht

13. Të bëhen analiza për gjendjen kreditore të TVSH-së dhe tatimit mbi fitimin sipas drejtorive rajonal tatimore, të dalin prirjet dhe në bashkëpunim me strukturat e kontrollit tatimor të ushtrohen kontrolle sipas vlerësimit që do të bëhet

Vazhdimisht

14. Të bashkëpunohet me kontrollin tatimor për subjektet me humbje për të programuar dhe ushtruar kontrolle, veçmas në ato subjekte që mund të vetdeklarohen të tillë për periudha tatimore më shumë se një vit

Vazhdimisht

15. Të bëhen analiza për dhënien e rimbursimeve të TVSH, saktësimin e shumave të kërkuara për rimbursim, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në miratimin dhe likuidimet e kryera, për periudhën objekt i këtij Auditimi

Brenda vitit ushtrimor 2012

16. Të bëhen analiza e të dokumentohen, problemet e konstatuara lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, përfshirë impaktin e bashkëpunimit të DPT me ISSH

Vazhdimisht

17. Nga të dhënat e paraqitura në bilancin e vitit 2011, gjendja e debitorëve në vlerën 3.457.592 lekë (vjedhjet e bëra gjatë vitit 1998), mbartet nga viti në vit, që nga viti 1998, prandaj duhet të bëhen relacionet dhe shpjegimet përkatëse dhe me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm të pasqyrohen në kontabilitet fshirja e tyre, duke kryer veprimet sipas rubrikave përkatëse në aktiv e pasiv të bilancit

Brenda vitit ushtrimor 2012

18. Të ndiqen procedurat ligjore për fshirjen nga pasqyrat financiare të bilancit të rubrikave të llogarisë 467 “kreditorë të ndryshëm”, e cila paraqitet në bilanc me vlerën 3,295,783 lekë të pandryshuar prej vitesh, që pasqyron disa kreditore jo real që janë përfshirë në kontabilitet për marrëdhënie jo kontraktuare. Për kryerjen me përgjegjësi të këtyre veprimeve, t`u kërkohet në rrugë shkresore zyrtare kreditorëve konfirmim se për vlerat kreditore sipas bilancit të DPT, nuk figuron kundërpartia si vlerë debitorë në bilancet e këtyre subjekteve. Në rast së subjektet kreditore nuk ushtrojnë aktivitet, të hartohet procesverbali përkatës dhe të paraqitet për miratim te Drejtori i Përgjithshëm

Brenda vitit ushtrimor 2012

19. DPT të studiojë mundësinë për të krijuar dhe përfshirë në strukturën organike një sektor apo drejtori që të programojë dhe koordinojë me Ministrinë e Financave si dhe të monitorojë realizimin e investimeve, duke përcaktuar dhe përgjegjësinë për detyrën funksionale në zbatim te Udhëzimit nr. 4 , datë 27.01.2011 neni 2.2. “detajimi dhe çelja e fondit për investime” pika 37, ku thuhet “ Njësitë shpenzuese, pasi marrin fondin e planifikuar për projektin e investimit zbatojnë procedurat e prokurimit, lidhin kontratën me palën sipërmarrëse dhe mbajnë përgjegjësi për hartimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin në fuqi

Brenda vitit ushtrimor 2012

20. . Gjatë vitit 2012, të organizohet puna për kryerjen e inventarëve duke trajtuar edhe materialet për jashtë përdorimit, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve” pika 1, ku thuhet “ Njësitë ekonomike, subjekte të këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe evidencës së tyre mbështetëse, pika 2. Inventarizimi i aktiveve dhe detyrimeve kryhen nën përgjegjësinë

dhe sipas procedurave të miratuara nga organi i drejtimit të njësisë ekonomike, që aktivet dhe detyrimet të paraqiten me vërtetësi dhe besueshmëri në pasqyrat financiare vjetore

Brenda vitit ushtrimor 2012

21. Nga Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse të merren masa dhe të bëhen ndryshimet e kërkuara sipas Projekt Raportit për zbatimin e Urdhrit nr. 6684, datë 23.04.2010, pikës 5 të tij, paragrafi katërt, ku cilësohet se... ”grumbullojnë administrojnë e përpunojnë fletët e udhëtimit për çdo automjet”, në mënyrë që fletët e udhëtimit të plotësohen duke pasqyruar drejtimet e lëvizjeve të automjetit sipas destinacionit të shërbimit, firmosen nga shoferi i automjetit dhe personi i ngarkuar për kryerjen e shërbimit. Gjithashtu të mbahen kartelat për çdo automjet ku të regjistrohen të dhënat për karakteristikat e automjetit, riparimet e kryera ne vite dhe vlera e amortizimit të llogaritur sipas normës përkatëse të amortizimit

Vazhdimisht

22. Vendimet e emërimit të punonjësve tatimorë në përmbajtjen e tyre të kenë të shënuar numrin e vendimit për përfitimin e kategorisë së vendit të punës në përputhje me tabelën e pagave sipas VKM nr. 1184, datë 20.08.2008 i ndryshuar (A,B,C1,C2 etj.), kategorinë e pagës sipas kategorisë së vendit të punës të përfituar në përputhje me nivelin minimal të diplomës sipas pozicionit të punës

Vazhdimisht

23. Të gjithë punonjësit tatimorë që do të emërohen në pozicionet e punës A,B,C1,C2 dhe C3, ku respektivisht u korrespondojnë kategoritë e pagave sipas tabelës së pagave dhe organigramës së përcaktuar nga MF, të mbahet parasysh niveli minimal i diplomës përfituar nga punonjësi në raport me pozicionin e punës pavarësisht nga edukimi arsimor i përfituar

Vazhdimisht

24. Për çdo rast të marrjes së masës së largimit nga struktura e shërbimit civil të punonjësve tatimor, në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 neni 21 e 22 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kur punonjësi i larguar ka fituar të drejtën e rikthimit në punë dhe dëmshpërblimin në pagë, çështja duhet të analizohet dhe të dalë përgjegjësia ndaj personave shkaktarë përgjegjës që nga fillimi i ecurisë disiplinore

Vazhdimisht

25. Në zbatim të VKM nr. 335, datë 20.06.1998 “Për procedurat e zbatimit të vendimeve gjyqësore” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij, të analizohen rastet e zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me efekte financiare në buxhetin e shtetit dhe nxirret përgjegjësia e personave shkaktarë përgjegjës

Vazhdimisht

B. <u>Masa Disiplinore</u>

Mbështetur në nenin 25, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

1. “Vërejtje me shkrim”, neni 25 pika 3 gërma “a”, për tre punonjës, për Mos zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 7 i tij, “Inventari i aktiveve dhe detyrimeve”, trajtuar hollësisht në faqen 99 të Raportit Përfundimtar të Kontrollit, si dhe mos zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 33 i tij,trajtuar hollësisht në faqet 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25 pika 3 gërma “b” për një punonjës, për Plotësimin e dokumentacionit dhe konceptimin e vendimeve të emërimit të punonjësve sipas kategorisë së vendit të jo në përputhje me nivelin minimal të diplomës dhe pagesave të kryera në kundërshtim me shkresën e Ministrisë së Financave nr. 1086, datë 08.09.2010, shkresën e Ministrisë së Arsimit nr. 5280, datë 19.08.2010 “Mbi zbatimin e vendimeve të pagave” me VKM nr. 860, datë 27.04.2009, nr. 605, datë 08.07.2010 dhe nr. 545, datë 11.08.2011 në vlerën prej 1,991,000 lekë për 15 punonjës (evidentuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, pasqyra ANEKS 3).

<u>Shënim</u>: Auditimi u krye nga audituesit z. Kristaq Gjurgjaj, përgjegjës grupi, z. Odhise Veshi, anëtar, z. Aqif Klosi, anëtar, z. Xhovan Domi, anëtar, z. Agim Mandri, anëtar. Më tej u shqyrtua nga Kryeauditues i Departamentit z. Edvin Stefani, Drejtori i Departamentit z. Aleksandër Lipivani dhe Drejtori i Drejtorisë

Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.